

Faktorët që çojnë në radikalizëm dhe esktremizëm të dhunshëm

- **Faktorë shtytës:**

- socio-ekonomikë (izolimi social, arsimimi, etj.);
- politikë (elitat e dobëta politike – shteti i dobët);
- kulturorë (feja, sfidat globaliste ndaj kulturës tradicionale, kërkimi për kuptim në jetë)

- **Faktorë tërheqës:**

- dëshira për aventurë dhe fame;
- plotësim i boshllëkut shpirtëror të munguar;
- fuqizim qytetar si pjesë e klanit;
- kushte më të mira jetese (grupet ekstremiste ofrojnë shërbime/të ardhura në këmbim të anëtarësimit).

Motivet

Motivet kryesore të përfshirjes në ekstremizmëm të dhunshëm ndahen në tre grupime:

- Dhuna ideologjike:
 - (a) Ideologjitë politike siç janë grupet nacionaliste, neonaziste, etj.,
 - (b) interpretime ekstreme të ideologjive fetare dhe besimeve
 - (c) anarkistët e majtë të dhunshëm dhe ideologjitë djathtiste;
- Dhuna që bazohet në kauza:
 - (a) lëvizjet e dhunshme për të drejtat e kafshëve;
 - (b) ekstremizmi mjedisor ose ekologjik
 - (c) levizjet antiqeveritare, anti-globaliste ose antikapitaliste që përkrahin përdorimin e dhunës;
- Dhuna etno-nacionaliste ose separatiste.
 - Betejat e dhunshme politike ose të pavarësisë që kanë në themel racën, kulturën, gjeografinë
 - ose etninë;

Identifikimi i rrezikshmërisë

- Identifikimi i rrezikshmërisë së qytetarëve bëhet duke marrë në konsideratë tre dimensione:
 - Angazhimi me një grup, kauzë ose ideologji.
 - Qëllimi për të shkaktuar dëme.
 - Aftësia për të shkaktuar dëme.

Etapat e procesit të radikalizimit

Etapa 1	Etapa 2	Etapa 3	Etapa 4
<ul style="list-style-type: none">• Vendorsja e kontaktit midis “radikalizuesit” dhe një personi të hapur ndaj ideve radikale.	<ul style="list-style-type: none">• Ndryshim gradual i sjelljes – ndryshim në sjellje.• Zakone/forma të reja komunikimi (kryesisht nëpërmjet internetit).	<ul style="list-style-type: none">• Ndryshim i jetës sociale, duke u shoqëruar gjithnjë e më shumë me individë me mentalitet të ngjashëm. (Socializim)• Ndërprerje ose kufizim i lidhjeve shoqërore me familjen dhe miqtë e mëparshëm.	<ul style="list-style-type: none">• Procesi i “kalitjes” morale, kryesisht duke parë video shumë të dhunshme dhe skena luftimi.• Largimi drejt zonave të luftimit, ose përfshirje në akte terroriste në vend

Masat parandaluese për qytetarët e rrezikuar

- Këshillim individual;
- Përmirësimi i aftësive sociale, menaxhimi i zemërimit/ankthit;
- Këshillim/ndërgjegjësim për përdorimin e drogës dhe alkoolit.
- Këshillim/asistencë edukimi;
- Këshillim/asistencë punësimi;
- Këshillim/asistencë për marrëdhëniet familjare;
- Këshillim/asistencë shëndeti;
- Mbështetje për strehim;

LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE NENI 29

Bashkia është përgjegjese për garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve.

- Planifikimi strategjik
- Shëndeti publik
- Mirëqënia sociale
- Infrastruktura dhe mjedisi
- Rendi dhe siguria

STRUKTURA E MEKANIZMA

NE NIVEL LOKAL

Policimi në Komunitet

Modeli i policimit në komunitet mbështetet në tre shtylla kryesore:

- **Partneriteti me komunitetin.** Bazuar në konceptin që komuniteti/qytetarët duhen të jenë pjesë e zgjidhjes të problemeve të sigurisë duke krijuar ndjenjën e përgjegjësisë së përbashkët.
- **Adresimi i shkaqeve që çënojnë sigurinë.** Bazuar në parimin e proaktivitetit dhe të punës parandaluese për adresuar shkaqet që çënojnë sigurinë në komunitet apo faktorevë të tjerë stimulues.
- **Përmirësimi organizativ.** Bazuar në parimin se për të qënë në gjendje të ofrojë shërbime cilësore ndaj komunitetit, Policia duhet të udhëhiqet nga standarde të larta profesionale dhe etike.

Shkolla si qëndër komunitare

Mekanizmi synon ta kthejë shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe një mjedis që i shërben komunitetit.

Veprimtaritë e parashikuara të shkollës si qendër komunitare grupohen në katër lloje:

- Konsultimet/kurse/klube që ngrihen mbi përmbajtjen e lëndës që nxënësi po zhvillon në klasën e tij dhe thellojnë dijet në një fushë të caktuar kurrikulare;
- Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportive;
- Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes;
- Veprimtari për angazhimin e komunitetit.

Mekanizmi i referimit të dhunës në familje

Ky mekanizëm është i përbërë nga tre struktura:

- **Komiteti drejtues** – kryesohet nga kryetari I bashkisë. Identifikon problemet e dhe propozon zgjidhje, përcakton rregullat e funksionimit të ekipit teknik ndërdisiplinor, etj
- **Ekipi teknik ndërdisiplinor** – menaxhon rastet dhe plotëson nevojat e viktimave, koordinon mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve, monitoron dhe raporton në komitetin drejtues, etj.
- **Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare** - drejton dhe koordinon ekipin teknik ndërdisiplinor, ndërmjetëson me institucionet e përfshira dhe OJF-të, asiston viktimat për ndjekjen e procedurave dhe plotësimin e dokumentacionit, etj.

Këshillat lokale për sigurinë publike

Në mungesë të një mekanizmi të posaçëm këshillat e sigurisë lokale janë forumi i përshtatshëm për të adresuar një pjesë e mirë të problematikës lokale.

Këshillat marrin vendime të cilat i dërgohen në formë rekomandimesh institucioneve përgjegjëse lokale.

Këshillat adresojnë faktorët shtytës në radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm dhe faktorë tërheqës si ekzistenca e grupeve ekstremiste lokale, predikimet e deformuara të udheqësve ideologjikë/shpirtërorë, etj.

Për komunitete më efektive - Diskutim

- ❑ Bashkia jonë ndërvepron dhe konsultohet me qytetaret dhe të rinjtë/të rejat për çështje të rëndësishme lokale, si?
- ❑ Bashkia jonë është e ndërgjegjshme për rolin e grave/vajzave për të pasur komunitete paqësore dhe ka përfaqësim të mirë të tyre në strukturat e saj, si?

Qytetarët e organizuar në proceset vetëqeverisëse

Komisionet këshillimore qytetare. Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor është një grupim vullnetar qytetarësh të angazhuar dhe aktivë, i cili shërben si organ konsultativ dhe këshillimor për bashkinë (jo vendimmarrës). Duke qenë gjithëpërfshirës, ai siguron përfaqësim dhe kontribut qytetar me bazë të gjerë në proceset konsultative dhe vendimmarrëse të qeverisjes vendore.

Të rinjtë dhe organizimi rinor

Bordi (këshilli) Rinor është një grupim vullnetar me të rinj aktivë, që synon të rrisë pjesëmarrjen e tyre në vendimarrje dhe në jetën komunitare.

Eksperienca ka dëshmuar se strukturat rinore janë aset i vyer për komunitetin dhe bashkinë.

Zëri i fortë dhe i drejtpërdrejtë i të rejave/të rinjve në formet lokale, ndikon më shumë se çdo zë tjetër në vendimarrje, e për pasojë dhe në zgjidhjen e problemeve.

Shoqëria civile dhe organizimi i saj

Roli i shoqërisë civile në një sistem qeverisje të decentralizuar përmbledh të paktën katër funksione:

- Funksionin e avokatit për përfaqësimin e interesave të zonave të tyre,
- Funksionin dhënies së shërbimeve në nivel lokal në fushat e edukimit, shëndetit, të pastrimit, etj,
- Funksionin e partnerit të qeverisë në planifikimin e zhvillimit, të mobilizimit të burimeve dhe të promovimit për një kuptim më të mirë të sistemit të decentralizimit,
- Funksionin e mbikqyrjes së aktivitetit qeveritar.

Gratë dhe organizimi i tyre

Fuqizimi i grave/vajzave dhe pjesëmarrja aktive e tyre në jetën publike, konsiderohet si gur themeli për të ndërtuar komunitete të qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit (UNSCR) 1325 e Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë, vë theksin mbi rëndësinë e tyre në përpjekjet për sigurinë për krijimin e paqes së qëndrueshme.

Në Shqipëri gratë/vajzat vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në vendimarrjen vendore dhe administratë.

Diskriminimi gjinor shton pabarazitë ekonomike, politike, sociale dhe bën që grate/vajzat të përballen në mënyrë disproporcionale me ofrimin e shërbimeve dhe shpërndarjen e burimeve.

Bashkësitë fetare

Mirëkuptimi dhe harmonia ndërfetare është një nga tri vlerat kulturore më të spikatura të shqiptarëve, krahas atyre të besës dhe mikpritjes.

Bashkësitë fetare janë persona juridikë jofitimprurës. Veprimtaria e 5 komuniteteve fetare rregullohet me ligj.

Institucionet e strukturat e krijuara nga bashkësitë fetare mund të ushtrojnë çdo lloj veprimtarie shoqërore, arsimore, shëndetësore e ekonomike, në përputhje me rregullat e bashkësisë, si dhe me legjislacionin në fuqi.